



Prishtine, data: 16.03.2021

KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE - Ne baze te Ligjit me nr.05/L-031 te procedurës se përgjithshme Administrativë dhe Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 mbi Procedurat e Qarkullimit te Dokumenteve, skanimi dhe ruajtje e tyre – arkivimi elektronik, ne lidhje me aktvendimin me numër te protokollit 3605 dt.22.12.2014 mbi shqiptimin e gjobës administrative ndaj: **Hazir Haziri**, person fizik me adresë; Studime e Epërme Komuna Vushtrri. , merr këtë vendim :

AKTVENDIM

1. Dorëzimi i mëtejshme i te gjitha shkresave dhe parashtrësave për **Hazir Haziri**, person fizik me adresë; Studime e Epërme Komuna Vushtrri, tani e tutje do te behet me afishimin e tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .
2. Komunikimi nga pika I e dispozitivit konsiderohet i kryer, pas kalimit te afatit prej 10 ditëve, nga dita e afishimit te tyre ne tabelën e shpalljeve ne Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale .

Arsyetim

Ndaj **Hazir Haziri**, person fizik me adresë; Studime e Epërme Komuna Vushtrri., KPMM ka leshuar aktin administrativ me nr. 3605 dt.22.12.2014.

Ne tentim qe t'i dorëzohet akti administrativ përputhje me nenin 7 par. 3 te Udhëzimit Administrativë me nr.001/2018 , nga fletë kthesa e kthyer nga posta dy herë me dt.14.09.2017 dhe me dt.02.07.2018 është konstatuar se pala nuk e ka pranuar aktin administrativ. Andaj, në pajtim me nenin 7.3.13 bëhet shpalljen publike të këtij akti administrativ.

Këshilla Juridike

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi administrative .



Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMISIONI I PAVARUR PER MINIERA DHE MINERALE	
NEZAVISNA KOMISIJA ZA RUDNIKE I MINERALE	
INDEPENDENT COMMISSION FOR MINES AND MINERALS	
DALJE	
DEPISEK	NR. PROT. 1027
DEPISEK	RR. PROT.
DEPISEK	NR. PROT.
NUMRI I FAKTIVE	DD MM VVVV 16/03/2021
NR. DOK. STRANA	DD MM VVVV
NR. OF PAGES	DD MM VVVV
PRISHTINE/A	



Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minaeralet, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nxjerre këtë:

AKTVENDIM

Ndaj Hazir Haziri nr. të letërnjoftimit mungon, person fizik me adresë; Studime e Epërme Komuna Vushtri.

1. Në pajtim me nenin 79 paragrafi 4 shqiptohet gjobë administrative për Hulumtimin e mineraleve Tufë me Piroklastite andezite- pa posedimin e Licencës për Hulumtime në shumë prej 5,000.00€ (Pesë mijë euro).

Arsyetim

Gjatë inspektimit të operimeve ilegale me datën 17.09.2014, Hazir Haziri në cilësinë e personit fizik është hasur duke operuar ilegalisht në Hulumtimin e resurseve minerare të Tufë me Piroklastite andezite. Inspektimi është bërë në lokacionin e fshatit Studime e Poshtme, komuna Vushtri. Gjatë inspektimit në vendin ku është kryer aktiviteti ilegal në hulumtimin e resurseve minerare pa posedimin e licencës për hulumtime, gjithashtu përshtet përkufizuar lokacioni me koordinata ku ju në cilësinë e personit fizik ishit duke ushtruar aktivitetet të paligjshëm i cili veprim ishte në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minaeralet si dhe Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Minaeralet.

Në ditën e inspektimit jeni udhëruar me anë të urdhëresës për ndërprerje të aktivitetit ilegal të lëshuar nga Inspektoret e Minerave në datën e inspektimit që menjëherë të ndërpreni aktivitetin e paligjshëm.

Inspektoret e Minerave kanë konstatuar se personi fizik Hazir Haziri, aktivitetin e operimeve ilegale e zhvillonte në lokacionin me këto koordinata; Y= 7503163; X= 4744728; Z(m) = 683, për të cilat koordinata nuk keni poseduar Licencë për Hulumtime e resurseve minerale të Tufë me Piroklastite andezite të lëshur nga KPMM-ja.

Afati për kryerjen e pagesës së gjobës administrative është 15 ditë nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, pagesa e faturës bëhet në Bankën Qendrore të Kosovës në këtë xhironlogari 1000430070005950.

Duke marrë parasysh arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Aktvendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga Drejtori i KPMM.


Rr. Armend Daci Nr 1 Prishtinë, Kosovë Tel: +381 (38) 240 252 Fax: +381 (38) 245 844 E-mail: ICMM@kosovo-mining.org Web: www.kosovo-mining.org	 3605 22/12/2014 SHKËRIMET	Kuvendi i Kosovës Skupština Kosova Assembly of Kosovo
--	-------------------------------------	---

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankimi administrativ brenda 30 ditëve nga dita kur pala e ka marrë njoftimin për nxjerrjen e aktvendimit. Ankimi administrativ i drejtohet Komisionit për Ankesa të KPMM.

Sipas nenit 128.2 të Ligjit për Procedurën Administrative, ankimi administrativ nuk e pezullon zbatimin e aktvendimit, sepse aktvendimi synon mbledhjen e taksave, tatimeve ose të ardhurave të tjera buxhetore.

Aktvendimi t'i dergohet:

Arkivesë së KPMM-së,
Departamentit të Finacave të KPMM-së,
Palës



Midin Bojaxhiu
Drejtor

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale